



Prishtinë, 16.04.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1132_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1, nënparagrafët 1.11 dhe 1.12, Neni 26, Neni 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Neni 30, Neni 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.2, Neni 34 dhe Neni 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Nenit 4 dhe 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 05.03.2019 nga ndërmarrja "Enerco LLC " SH.P.K, adresa: Bregu i Diellit, Hyzri Talla, 11/4, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

në seancën e mbajtur me datë 16 prill 2019 nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET LICENCA** për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes **Enerco LLC SH.P.K**, me numër Licence **ZRRE/Li_65/19**, për periudhën kohore prej 16.04.2019 deri me 15.04.2024.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë **05.03.2019** ka pranuar nga ndërmarrja **Enerco LLC SH.P.K**. Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Furnizimit me energji elektrike në Kosovë.
- o Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- o Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja Enerco LLC me datë 21 mars 2019 ka njoftuar përmes gazetës palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.



- Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditë kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive të tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes Enerco LLC SH.P.K dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes Enerco LLC SH.P.K dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LICENCË PËR FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE

DHËNË :

Enerco LLC SH.P.K.

Numri i Licencës: ZRRE/Li_65/19

Prishtinë, 16 prill 2019

